



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

4316

Nr. _____ Prot

Peshkopi, më 18/11.2024

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër **Nr.61**

Datë: 18.11.2024

**“MIRATIMIN E MARREVESHJES SE BASHKEPUNIMIT “ MBI PROGRAMIN
PER KRIJIMIN OSE SHTIMIN E FONDIT PUBLIK TE BANESAVE SOCIALE SI
DHE PER NDERTIMIN E BANESAVE ME KOSTO TE ULET NE BASHKINE
DIBËR”**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak





43/6/20/11/24

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.969/1 prot.

Peshkopi, më 19.11.2024

Lënda: Për vendimin nr.61, datë 18.11.2024 të Këshillit të Bashkisë Dibër.

BASHKISË DIBËR

DIBËR

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", i ndryshuar, neni 16, pas verifikimit për efekt ligjshmërie të vendimit të Këshillit të Bashkisë Dibër nr.61, datë 18.11.2024 "*Miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit "Mbi programin për krijimin ose shtimin e fondit publik të banesave sociale, si dhe për ndërtimin e banesave me kosto të ulët në Bashkinë Dibër"*, vendosa:

Miratimin në parim të vendimit objekt verifikimi dhe shqyrtimi në kushtet e zbatimit të legjislacionit aktual që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën përkatëse, nën përgjegjësinë direkte administrativo-ligjore të strukturave të posaçme të Bashkisë Dibër, që paraqesin për miratim projekt-akte të kësaj natyre.

PREFEKTI

Nexhbedin SHEHU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 61 Datë 18 / 11 /2024

“Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit “Mbi programin për krijimin ose shtimin e fondit publik të banesave sociale si dhe për ndërtimin e banesave me kosto të ulët në Bashkinë Dibër”.

Mbështetur në nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1; nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenin 24, pika 2, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, Vendimin nr. 814, datë 03.12.2004, të Këshillit të Ministrave “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”, vendimin nr. 574, datë 29.08.2012, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit, që duhet të paraqesë familja për t’u strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit, dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”, referuar shkreses nr. 1560 prot date 101.11.2024 derguar nga Enti Kombëtar i Banësive, Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 46 date 30.10.2024, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës **18.11.2024** me 19 vota pro, 0 kundër dhe 0 apstenim:

VENDOSI:

- I. Të miratojë marrëveshjen e bashkëpunimit “ Mbi programin për krijimin ose shtimin e fondit publik të banesave sociale si dhe për ndërtimin e banesave me kosto të ulët në Bashkinë Dibër”, sipas draftit bashkelidhur këtij projekt vendimi.
- II. Autorizohet Kryetari i Bashkisë për nënshkrimin e marrëveshjes.
- III. Ngarkohen Drejtoria e Juridike, Sektori i Administrimit të Pronave dhe Strehimit për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga Institucioni i Prefektit të Qarkut, Dibër.
- V. Vendimi u shpall me datë **18.11.2024**.

Kryetari i Këshillit Bashkiak

Irimi SHEHU





REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA DIBER
DREJTORIA JURIDIKE PROKURIMEVE E PRONAVE

PROJEKT - VENDIM
Nr. 11, date, 14 / 11 / 2024
PËR

“ MIRATIMIN E MARREVESHJES SE BASHKEPUNIMIT “ MBI PROGRAMIN PER KRIJIMIN OSE SHTIMIN E FONDIT PUBLIK TE BANESAVE SOCIALE SI DHE PER NDERTIMIN E BANESAVE ME KOSTO TE ULET NE BASHKINE DIBER ”

Mbështetur në nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenin 24, pika 2, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, Vendimin nr. 814, datë 03.12.2004, të Këshillit të Ministrave “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”, vendimin nr. 574, datë 29.08.2012, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit, që duhet të paraqesë familja për t’u strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit, dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”, referuar shkreses nr. 1560 prot date 10.11.2024 derguar nga Enti Kombëtar i Banësive, Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 46 date 30.10.2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë në mbledhjen e këshillit bashkiak të datës _____.____.2024

PROPOZON:

- I. Të miratojë marreveshjen e bashkepunimit “ Mbi programin per krijimin ose shtimin e fondit publik te banesave sociale si dhe per ndertim te banesave me kosto te ulet ne Bashkine Diber”, sipas draftit bashkelidhur ketij projekt vendimi.
- II. Autorizohet Kryetari i Bashkise per nenshkrimin e marreveshjes.
- III. Ngarkohen Drejtoria e Juridike, Sektori i Administrimit te Pronave dhe Strehimit për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut, Diber.

P/Sektorit te Adm. te Pronave
dhe Strehimit
Gazmend Miftari

KRYETARI I BASHKISE
RAHIM SPAHIU



Drejtori Juridik
Ismet Saraci



4113
04.11.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
ENTI KOMBËTAR I BANESAVE
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 1560 prot.

Tiranë, më 04.11.2024

Lënda: Përcjellje e draft Marrëveshjes së Bashkëpunimit “Mbi programin për krijimin ose shtimin e fondit publik të banesave sociale si dhe për ndërtimin e një banese me kosto të ulët në Bashkinë Dibër”, miratuar nga Këshilli Drejtues i EKB-së.

BASHKISË DIBËR

Për dijeni:

DEGËS RAJONALE TË EKB-së DIBËR

Në vijim të bashkëpunimit tonë të përbashkët mbi ndërtimin e një godine banimi nga Enti Kombëtar i Banesave në qytetin e Peshkopisë (Bashkia Dibër) për kategorinë e shtresave në nevojë për strehim të këtij komuniteti, nga ana jonë janë kryer procedurat e nevojshme për të miratuar nëpërmjet Këshillit Drejtues të institucionit këtë investim që do të financohet dhe sigurohet nga fondi i miratuar nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe pjesa tjetër që nevojitet për ndërtimin e objektit do të financohet nga fondet e vetë Entit Kombëtar të Banesave.

Lidhur me këtë, ju vemë në dijeni se kjo draft marrëveshje është shqyrtuar nga Këshilli Drejtues i EKB-së në mbledhjen e zhvilluar në muajin Tetor 2024, i cili me Vendimin Nr.46, prot. 1493/2 datë 30.10.2024, ka miratuar këtë draft marrëveshje që do të lidhet ndërmjet institucioneve tona.

Sa më sipër, lutemi të kryhen nga ana juaj hapat dhe procedurat e nevojshme për miratimin e draftit të marrëveshjes nga Këshilli Bashkiak dhe më pas nënshkrimin nga Kryetari i Bashkisë të ekzemplarëve të dërguar nga ana jonë.


Mirëpresim në një kohë sa më të shpejtë dërgimin nga ana juaj të kopjeve të marrëveshjes të nënshkuara, nga Kryetari i Bashkisë për të vazhduar më tej me procedurat për zbatimin e këtij projekti.


Bashkëlidhur do të gjeni, 4 kopje të draft-marrëveshjes së miratuar dhe një fotokopje të Vendimit të Këshillit Drejtues të EKB-së Nr.46, prot.1493/2 datë 30.10.2024.

Ju faleminderit për bashkëpunimin.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Stefan Çipa





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
ENTI KOMBËTAR I BANESAVE
KËSHILLI DREJTUES

Nr. 1493, prot.
12

Tiranë, më 31.10.2024

V E N D I M

I KËSHILLIT DREJTUES

Nr. 46 datë 30/10/2024

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT "MBI PROGRAMIN
PËR KRIJIMIN OSE SHTIMIN E FONDIT PUBLIK TË BANESAVE SOCIALE SI
DHE PËR NDËRTIMIN E BANESAVE ME KOSTO TË ULËT NË BASHKINË
DIBËR**

Këshilli Drejtues, në mbledhjen e zhvilluar në ambientet e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, sipas njoftimit nr.1493 prot, datë 22.10.2024, pas shqyrtimit të materialit të paraqitur nga Drejtori i Përgjithshëm, "Mbi zbatimin e programit për krijimin ose shtimin e fondit publik të banesave sociale si dhe për ndërtimin e banesave me kosto të ulët në Bashkinë Dibër", i përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe Drejtoria Teknike, mbështetur në Ligjin nr. 7582, datë 13.07.1992 "Për ndërmarrjet shtetërore" i ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 198, datë 04.05.1993 "Për krijimin e Entit Kombëtar të Banesave" i ndryshuar, si dhe në shkronjën (f) të nenit 14, dhe në Statutin e Entit Kombëtar të Banesave Nr.10584/2 prot., datë 02.10.2024, protokolluar me tonën me Nr.1177/1 prot, datë 04.10.2024:

V E N D O S I:

1. Të miratojë Marrëveshjen e Bashkëpunimit "Mbi zbatimin e programit për krijimin ose shtimin e fondit publik të banesave sociale si dhe për ndërtimin e banesave me kosto të ulët në Bashkinë Dibër", sipas draftit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e EKB-së për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KËSHILLIT DREJTUES

Alketa Përnaska





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI KOMBËTAR I BANESAVE

Nr. _____ prot, datë ____ / ____ / 2024

(Selia: Rruga e Kavajës, ndërtesa Nr.80, hyrja 1,
kati 5 (ish shtëpia botuese "Naim Frashëri" Tiranë)

BASHKIA DIBËR

Nr. _____ prot, datë ____ / ____ / 2024

(Selia: _____)

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

MBI PROGRAMIN PËR KRIJIMIN OSE SHTIMIN E FONDIT PUBLIK TË BANESAVE SOCIALE SI DHE PËR NDËRTIM TË BANESAVE ME KOSTO TË ULËT NË BASHKINË DIBËR

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjin nr.22/2018 "Për Strehimin Social", i ndryshuar, VKM nr.873 datë 11.11.2020 "Për përcaktimin e rasteve dhe të mënyrës së bashkëpunimit, ndërmjet pushtetit qendror e njësisive të vetëqeverisjes vendore, për krijimin ose shtimin e fondit publik të banesave sociale", si dhe në përputhje me Vendimin Nr.198 datë 4.05.1993 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Entit Kombëtar të Banesave" i ndryshuar:

Lidhet kjo marrëveshje bashkëpunimi, ndërmjet palëve:

- **Enti Kombëtar i Banesave**, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, Z. Stefan Çipa;
dhe
- **Bashkia e qytetit Dibër**, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë, Z.Rahim Spahiu.

Neni 1

Qëllimi i marrëveshjes

1. Qëllimi i kësaj marrëveshje është të përcaktojë angazhimin e ndërsjellë të Entit Kombëtar të Banesave dhe të Bashkisë Dibër, me mbështetjen e drejtpërdrejtë edhe të Ministrisë së Ekonomisë,

Kulturës dhe Inovacionit, për një bashkëpunim në funksion të përcaktimit të fushave, masave dhe mënyrave të bashkëpunimit, si dhe të sigurimit të mbështetjes së nevojshme institucionale nëpërmjet zbatimit të legjislacionit të fuqi me pikësynimin:

- a) për të kontribuar në përmbushjen e objektivave të Qeverisë për politikën sociale të strehimit, si një nga prioritetet e saj;
- b) për të adresuar problemet e strehimit për shtresat të cilat nuk mund të përballojnë dot çmimet e banesave në tregun e lirë;
- c) për të realizuar ndërtimin e një banese me kosto të ulët dhe efikasitet energjie, me qëllim mundësimin e krijimit apo shtimit të fondit publik të banesave sociale për Bashkinë Dibër si dhe mundësimin e zbatimit të programit BKU;
- d) për të miratuar në parim, vazhdimin e bashkëpunimit në fushën e strehimit, duke eksploruar bashkërisht forma të tjera ligjore.

Neni 2

Objekti dhe Kushtet e marrëveshjes

1. Objekt i akt-marrëveshjes është financimi dhe ndërtimi gjatë viteve 2024-2028, i një objekti banimi me 6 kate banimi dhe me një kat parkimi nëntokë.
2. Financimi i objektit të banimit do të realizohet dhe sigurohet nga fondi i miratuar nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në vlerën 80.485.000 lekë dhe pjesa tjetër që nevojitet për ndërtimin e objektit do të financohet nga fondet e vetë Entit Kombëtar të Banesave.
3. Objekti i banimit klasifikohet i ndërthurur në programin e krijimit apo shtimit të fondit publik të banesave sociale si dhe në programin e banesave me kosto të ulët dhe do të shërbejë për strehimin e familjeve në nevojë që kanë aplikuar pranë Bashkisë Dibër për t'u strehuar në banesa sociale me qira, si dhe për strehimin e familjeve në nevojë që kanë aplikuar pranë Bashkisë Dibër për të përfituar banesë me kosto të ulët.
4. Apartamentet që do të përftohen nga ndërtimi i këtij objekti banimi, do të ndahen në proporcion me vlerat e financuara për ndërtimin e këtij objekti: Bashkia Dibër do të përfitojë numrin e apartamenteve që do të trajtohen si banesa sociale me qira dhe që do t'i korrespondojnë vlerës që financohet nga MEKI dhe Enti Kombëtar i Banesave do të përfitojë numrin e apartamenteve që do të trajtohen si banesa që shiten me kosto të ulët dhe që do t'i korrespondojnë vlerës që financohet nga vetë EKB. Ndarja proporcionale e apartamenteve do të specifikohet në një aneks marrëveshje të mëvonshme që do të lidhet ndërmjet palëve, në momentin që do të jetë përcaktuar dhe saktësuar kostoja përfundimtare e objektit të banimit.
5. Apartamentet e destinuara për programin e krijimit apo shtimit të fondit publik të banesave sociale, do t'i kalojnë në pronësi Bashkisë Dibër nëpërmjet kontratës së dhurimit dhe të gjitha shpenzimet që do të nevojiten për kalimin e pronësisë së këtyre apartamenteve do të përballohen nga Bashkia Dibër.
6. Apartamentet e destinuara për programin BKU do të mbeten në pronësi të EKB-së dhe do të shiten sipas kushteve dhe kriterëve të parashikuara në këtë marrëveshje si dhe procedurave ligjore

të përcaktuara me vendimmarrje të Këshillit Drejtues të EKB-së për shitjen e banesave me kosto të ulët që ndërtohen me fondet e vetë institucionit.

Neni 3

Angazhimet, detyrimet dhe përgjegjësitë e palëve

1. Palët e kësaj marrëveshje angazhohen:

- Të bashkëpunojnë me vullnet të lirë dhe në mënyrë konstruktive në drejtim përmbushjes së qëllimit të kësaj marrëveshje, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi;

- Në çdo rast, kur është e mundur, të publikojnë vlerat dhe kontributet e njëra-tjetrës në këtë projekt të përbashkët.

2. Enti Kombëtar i Banesave, si palë e kësaj marrëveshje, merr përsipër:

a) të realizojë: financimin pjesërisht të banesës; projektimin, ndërtimin, mbikqyrjen, kolaudimin dhe regjistrimin e pasurisë në emër të Entit Kombëtar të Banesave;

b) të vendosë në dispozicion të Bashkisë Dibër të dhënat teknike-ekonomike të një banese (strukturat, sipërfaqet, çmimet e apartamenteve, etj), si dhe kritere të tjera paraprake që konsiderohen të domosdoshme nga EKB (psh. minimumin e të ardhurave që duhet të ketë familja përfituese etj.), në funksion të përzgjedhjes, hartimit dhe miratimit të listave të familjeve përfituese nëpërmjet Këshillit Bashkiak, për pjesën e apartamenteve që do të financohen nga EKB dhe që do të shiten si banesa me kosto të ulët.

3. Bashkia Dibër, si palë e kësaj marrëveshje merr përsipër:

a) Të vërë në dispozicion të projektit:

- truallin ku do të ndërtohet objekti i banimit me sipërfaqje 1080 m², të ndodhur në Zonën Kadastrale 2932 me nr.pasurie 7/107, të lirë fizikisht dhe juridikisht/ligjërish, nëpërmjet kontratës së dhurimit për dhurimin dhe kalimin e pronësisë së truallit në favor të EKB-së dhe për të cilin Bashkia Dibër duhet të disponojë certifikatën për vërtetim pronësie.

-dokumentacionin tekniko-ligjor (certifikatën për vërtetim pronësie të lirë nga çdo kufizim, barrë hipotekore, etj..) që disponohet për truallin ku do të ndërtohet;

b) të vërë në dispozicion të EKB-së lejen përkatëse të zhvillimit dhe ndërtimit për objektin e banimit, brenda afatit ligjor nga momenti i aplikimit online nga EKB për këtë objekt, të pajisur me studim;

c) të eliminojë pagesën e taksës mbi infrastrukturën me Vendim nga Këshillit Bashkiak;

d) të investojë për sistemimin dhe infrastrukturën e zonës, duke përfshirë edhe rrjetin inxhinierik;

e) të sigurojë brenda një afati 2 (dy) mujor nga data e njoftimit/kërkesës nga Enti Kombëtar i Banesave (*referuar nenit 73, pika 2/a të Ligjit Nr.22/2018 i ndryshuar*), sipas kritereve të negociuara mes palëve, listën e familjeve përfituese për pjesën e apartamenteve të banesës që do

të financohen nga EKB dhe që do të shiten si banesa me kosto të ulët për programin BKU, të miratuar nga Këshilli Bashkiak Dibër ku të jenë specifikuar për çdo familje përfituese: pallati, kati, numri i apartamentit, struktura, sipërfaqja respektive dhe statusi i familjes nëse ka në përbërje persona PAK.

f) të garantojë EKB-në se do të përgjigjet për çdo detyrim ndaj palëve të treta të cilat kanë dhe/ose mund të ngrenë pretendime për truallin që vendoset në dispozicion për realizimin e këtij investimi.

4. Palët bien dakord që:

a) Ndarja e apartamenteve të banimit që do të financohen nga EKB, për familjet që do të përfitojnë strehim nga ky investim nëpërmjet shitjes së këtyre apartamenteve nga EKB si banesa me kosto të ulët, do të bëhet me vendim të Këshillit Bashkiak Dibër, sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara nga Enti Kombëtar i Banesave, konform legjislacionit në fuqi.

b) Mënyra e shitjes për apartamentet e kësaj banese që do të financohen me fondet e EKB- do të realizohet duke zbatuar një nga mënyrat e miratuara me Vendimin e Këshillit Drejtues të Entit Kombëtar të Banesave, mbështetur në legjislacionin në fuqi.

Neni 4

Vlefshmëria dhe zbatimi i marrëveshjes

Kjo marrëveshje është e vlefshme për një periudhë 4 (katër) vjeçare nga momenti i nënshkrimit të saj nga palët. Vlefshmëria e marrëveshjes mund të zgjatet me mirëkuptimin dhe vullnetin e palëve, kur këta të fundit nuk i kanë përmbushur detyrimet e tyre në kohë. Marrëveshja mund të rishikohet dhe të ndryshojë vetëm me shkrim dhe nëpërmjet një apo disa aneks marrëveshjeve që mund të lidhen nga palët, brenda afatit të vlefshmërisë së kësaj marrëveshje.

Palët duhet të bëjnë çdo përpjekje për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes tyre me negociata direkte dhe me mirëkuptim. Në rast të kundërt, mosmarrëveshjet do të zgjidhen sipas procedurave juridike ligjore në fuqi, bazuar në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 5

Bashkërendimi i marrëveshjes

Palët bien dakord të përcaktojnë një/disa përfaqësues si pikë kontakti për secilën palë me qëllim bashkërendimin e punës në praktikë. Këta përfaqësues do të kenë kontakte direkte me institucionet respektive.

Pikat e kontaktit duhet të mbajnë të informuar në çdo kohë titullarin e palës përkatëse mbi ecurinë e zbatimit të marrëveshjes.

Neni 6

Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe:
- dy kopje për Drejtorinë e Përgjithshme të Entit Kombëtar të Banesave;

Adresa: Rr. e Kavajës, ndërtesa nr.80, hyrja 1, kati 5, (ish shtëpia botuese Naim Frashëri) Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 42 227 796, email: info@ekb.gov.al; www.ekb.gov.al


- dy kopje për Bashkinë e qytetit Dibër.

Kjo marrëveshje hyn në fuqi pasi të jetë miratuar paraprakisht me vendimarrje nga Këshilli Drejtues i EKB-së dhe nga Këshilli Bashkiak i Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore, si dhe me pas me nënshkrimin e saj nga palët përkatëse (Drejtori i Përgjithshëm i EKB-së dhe Kryetari i Bashkisë).

PËR
ENTIN KOMBËTAR TË BANESAVE

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Stefan Çipa



PËR
BASHKINË DIBËR

KRYETAR

Rahim Spahiu